



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCES-**

Tiranë më 18/09/2013

Njoftim për Shtyp

Mbi nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me Autoritetin Italian të Konkurrencës

Ditët e fundit Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës dhe Autoriteti Italian i Konkurrencës, nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi në vijim të projektit të Binjakëzimit, të financuar nga Komisioni Evropian.

Bazat e memorandumit të mirëkuptimit janë të fokusuara kryesisht mbi shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave jokonfidenciale, organizimin e vizitave studimore, organizimin e konferencave të përbashkëta, organizimin e vizitave dypalëshe në nivele drejtuesish dhe ekspertësh, etj.

Memorandumi shënon një hap të rëndësishëm në rritjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve dhe për më tepër siguron një bashkëpunim afatgjatë për Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës, mbi ndarjen e eksperiencës dhe burimeve me institucione të konsoliduara të Bashkimit Evropian në fushën e konkurrencës.